



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 12/2018 regjistër (JR)
Datë 04.09.2018

Nr. 10 i vendimit
Datë 19.11.2018

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Kryesuese	Ina Rama
Relatore	Natasha Mulaj
Anëtare	Albana Shtylla
Anëtar	Ardian Hajdari
Anëtar	Luan Daci

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 19.11.2018, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jakobs, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 25, datë 20. 06. 2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 62, 63, 64, 65 dhe 66, pika 1, germa “b” e Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 25, datë 20.06.2018, ka vendosur:
 - Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Trenova, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë.
 - Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 - Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Komisioni mori në shqyrtim të tria kriteret e parashikuara nga neni 4 i ligjit nr. 84/2016. Vendimi për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Gentian Trenova është marrë duke u bazuar në kriterin e pasurisë dhe atë të aftësive profesionale.

Komisioni në vendimin e tij është ndalur konkretisht në këto pasuri të subjektit Gentian Trenova:

1. Apartament me sipërfaqe banimi 50 m², me adresë Rr. “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, apartamenti {***}, kati {***}, Tiranë.
2. Shtesë kati mbi apartamentin me sipërfaqe banimi 50 m², me adresë rruga “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, ap. {***}, Tiranë.
3. Dhurime monetare dhe hua si më poshtë:
 - a. Dhurim në prill të vitit 2012, në shumën 5.000 euro, nga prindërit e bashkëshortes.
 - b. Dhurime në shumën 1.200 euro dhe 25.000 lekë të dhuruara nga të afërmit.
 - c. Hua në shumën 300.000 lekë të dhëna nga motra dhe nëna në vitin 2012.

Përfundimisht, Komisioni në arsyetimin e tij për këto tri pasuri ka konkluduar se:

3. Subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova lidhur me kriterin e pasurisë ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për vlerësimin profesional, Komisioni për këtë kriter, ka hetuar në mënyrë të pavarur nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme mbi dosjet e përzgjedhura me short për çështjet e mëposhtme:

Çështja nr. 1 - Vendimi për pushimin e procedimit penal, datë 04. 03. 2016, “Korrupsionit aktiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në emër të shtetasit A. L. dhe “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” në zbatim të neneve 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, me të dyshuar të panjohur.

Cështja nr. 2 - Vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 30.03.2015, për hetim pasuror mbi pasurinë në aktet e referuara me nr. 18, të vitit 2015, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shtetasin V. L.

4. Komisioni, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, e konsideron subjektin e rivlerësimit “të papërshtatshëm”, si dhe një subjekt i cili nuk arrin një nivel të besueshëm në sistemin e drejtësisë, pasi është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë.
5. Kundër vendimit të mësipërm të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova, i cili kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë të subjektit, duke parashtruar këto shkaqe:
 1. Në media janë transmetuar të dhëna, mbi bazën e të cilave kryesuesi i trupit gjykues të Komisionit, Lulzim Hamitaj, që ka dhënë vendimin ndaj subjektit të rivlerësimit Gentian Trenova, është përzgjedhur komisioner në kundërshtim me parashikimet ligjore, dhe konkretisht nenin 6, germa “gj” e ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, i kërkohet Kolegjit, të verifikojë kushtet e emërimit të komisionerit Lulzim Hamitaj, me qëllim konstatimin e pavlefshmërisë së emërimit të tij në detyrë, e për rrjedhojë pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit nr. 25, datë 20.06.2018, për shkak të mos formimit të trupit gjykues.
 2. Vendimi i Komisionit është në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas parashikimeve të këtij neni, subjekti i rivlerësimit mund të shkarkohet nëse plotësohen në mënyrë kumulative dy kritere, pamjaftueshmëri në kontrollin e figurës dhe në atë të pasurisë, pra nëse subjekti i rivlerësimit është i pastër nga ana e figurës dhe ka probleme në kriterin e pasurisë, por jo dyfishin e pasurisë siç parashikohet në pikën a të nenit 61, atëherë nuk plotësohet parashikimi i nenit 61/3 për shkarkimin e subjektit. Në rastin konkret për subjektin e rivlerësimit nuk janë konstatuar probleme nga DSIK dhe vetë Komisioni për figurën.
 3. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016, pasi Komisioni i ka atribuuar vetes kompetenca që i përkasin organeve të tjera, të cilat kontrollojnë figurën dhe etikën e magjistratit. Sipas Komisionit për shkak të lidhjes së dy kontratave për të njëjtën pasuri, si dhe ndër marrja e veprimeve fiktive në ZVRPP Tiranë për regjistrimin e kontratës së fitimit të pronësisë dhe çmimit të vërtetë të transaksionit janë veprime që cenojnë rëndë pastërtinë e figurës dhe etikën e magjistratit. Këto përfundime nuk gjejnë bazë ligjore, pasi ligji nr. 84/2016, neni 34 e vijues e lidh pastërtinë e figurës së magjistratit me kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Vendim marrja e Komisionit nuk duhet të tejkalojë parashikimet e bëra në ligjin nr. 84/2016. Edhe nëse do të konstatohej ndonjë shkelje që parashikohet në një ligj tjetër, Komisioni duhet t’ia referojë atë organit kompetent.
 4. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenet 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi objekt i veprimtarisë së Komisionit është kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, etj., të cilat janë deklaruar në deklaratën përkatëse në aneks të ligjit, dhe jo saktësia e deklaratave të bëra në vite ILDKPKI.
 5. Në seancën dëgjimore të datës 14.06.2018, nga ana e Komisionit është lejuar një shkelje e rëndë procedurale në kundërshtim me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 pasi vëzhguesi ndërkombëtar ka ndërhyrë në kundërshtim me ligjin, duke mos bërë pyetje, por duke dhënë

komente dhe opinione, të cilat cenonin dinjitetin e subjektit. Nga ana e përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim: ONM) janë dhënë vlerësime negative dhe mendime në mënyrë publike, të cilat kanë influencuar në vendimmarrjen e Komisionit, në një moment të fjalimit të tij, përfaqësuesi i ONM-së i është drejtuar në mënyrë sugjestionuese Komisionit duke i thënë: *“deklarimet e subjektit të rivlerësimit vënë në diskutim karrierën e tij.”*

6. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim të hapur me nenin 17 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim: KEDNJ), si dhe protokollet shtesë të kësaj konvente. Nga ana e Komisionit janë shkelur hapur dhe në mënyrë të përsëritur parimet dhe të drejtat e njeriut për një proces të rregullt ligjor, e drejta e privatësisë familjare e drejta për mosdënim ose mosndëshkim pa ligj, e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta për një proces të pavarur. I gjithë hetimi administrativ, mënyra e ndërtimit të pyetjeve, oraret e dërgimit të pyetjeve, jashtë orarit zyrtar në disa raste, koha e shkurtër e lënë në dispozicion për të paraqitur prova dhe për të dhënë përgjigje për gjëra të ndodhura vite më parë, të cilat kërkonin kohë fizike për t’u përgatitur dhe kujtuar, marrja dhe kërkimi i informacioneve dhe i të dhënave të panevojshme për familjarët që nuk janë subjekte të deklarimit të pasurisë apo tatimeve, si dhe pyetjet për pasuritë e tyre, tregojnë qartë se qëllimi i organit të *vetting*-ut nuk ka qenë sqarimi i rrethanave të paqarta, por krijimi i një situatë stresi, shqetësimi të vazhdueshëm, presioni, shantazhi psikologjik, si dhe për të krijuar kurthe për të vendosur subjektin e rivlerësimit në gabim njerëzor për ta përdorur më pas kundër tij.
7. Komisioni ka shkelur parimin për një proces të rregullt ligjor, duke paragykuar çështjen dhe duke paracaktuar vendimin, pasi i njëjti Komision që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, i njëjti Komision (me të njëjtët anëtarë) ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit, pra në konflikt të hapur interesi, në kundërshtim të hapur me parimin e kontradiktoritetit në një proces të rregullt gjyqësor, në kundërshtim të hapur me parimin për një gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë.
8. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për kalimin e barrës së provës, nen i cili është shkelur nga ana e Komisionit, pasi ky i fundit, pa dhënë arsye, nuk ka pranuar si prova shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e tjera, të dorëzuara në cilësinë e provës, duke paragykuar procesin, duke vendosur që në fillim mënyrën se si do të përfundonte, pra shkarkimin, dhe kthimin e procesit në një formalitet, të shoqëruar me forma të presionit psikologjik (pyetjen disa herë për të njëjtën gjë). Me paraqitjen e shpjegimeve dhe të akteve të tjera, në bazë të parashikimeve ligjore ezaurohet edhe barra e provës për subjektin dhe që nga ky moment barra i kalon përsëri Komisionit për të marrë prova të tjera, të cilat do të rrëzonin pretendimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni nuk ka respektuar parimin e kontradiktoritetit midis palëve në procesin e hetimit administrativ dhe atë të gjykimit në seancë publike (faqe 37 ankimi, par.3), duke i dhënë vlerë vetëm dyshimeve të saj, duke mos marrë për bazë vlerën provuese të shpjegimeve dhe akteve të dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit.
9. Vendimi i Komisionit është në kundërshtim me vendime të tjera të Komisionit, të dhëna më pas për subjekte që kanë kaluar me sukses kualifikimin, pasi duke bërë krahasimin me këto vendime, del qartë edhe qëndrimi diskriminues në krahasim me të tjera subjekte, duke bërë edhe shkelje të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollit

respektiv. Për këtë arsye në trajtimin e kërkesës ankimore, Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet të marrë si prova të reja edhe vendimet e Komisionit për subjektet e kualifikuar, si: Bashkim Dedja, Vitore Tusha, Edmond Islamaj, Xhezair Zaganjori, Ardian Dvorani, Kostaq Beluri, Fatjona Memcaj, Antoneta Sevdari, Manjola Xhaxho, Marcela Shehu, Vate Stakaj, Ilir Toska, Nertina Kosova, Astrit Faqolli, Brikena Lubonja, Anila Leka, Dritan Prençi, Besnik Muçi, Gentian Medja, Brunilda Kadi, Dritan Hallunaj, si dhe të gjitha vendimet e tjera të dala deri në datën e gjykimit nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

10. Komisioni nuk është gjykatë në kuptimin e nenit 6 të KEDNJ-së, por më së shumti një organ administrativ. Për këtë arsye, Kolegji duhet ta shqyrtojë çështjen si gjykatë e shkallës së parë, të marrë prova, të bëjë debat gjyqësor mbi provat, të shqyrtojë shkeljet procedurale të Komisionit, si dhe t'i kërkojë organit administrativ, Komisionit, të arsyetojë me prova vendimin e tij.
11. Pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 bien në kundërshtim me Kushtetutën, pasi ligji, në kundërshtim me parashikimet kushtetuese, ka parashikuar raste të tjera në pikat 3 dhe 5 të nenit 61, për shkarkimin e gjyqtarit apo prokurorit, të cilat nuk janë të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta, në asnjë rresht të saj. Për këtë arsye i kërkoj Kolegjit, i cili në rolin e gjykatës dhe me kompetencën e nenit 145 paragrafi i dytë, të Kushtetutës, përpara se të japë vendimin përfundimtar të formës së prerë, të pezullojë gjykimin dhe t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese për interpretim nëse këto dispozita bien ndesh me Kushtetutën.
12. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenin 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni nuk e ka bërë vlerësimin profesional bazuar në të gjitha dokumentet e marra për rivlerësim, por është bazuar vetëm në dy prej dokumenteve, dhe nuk ka analizuar asnjë prej dokumenteve të tjerë.
13. Në lidhje me kriterin profesional, Komisioni ka gabuar kur nuk ka marrë në konsideratë raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme më datë 11.01.2018, raport i cili është një ndër llojet e provave që komisioni ishte i detyruar që ta konsideronte dhe të arsyetonte se përse nuk i jepte vlerë prove në drejtim të vlerësimit profesional si i përshtatshëm me detyrën.
14. Në lidhje me pasurinë “Apartament në rr. “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, shuma 12.000 euro është plotësisht e justifikuar. Çmimi me të cilin është shitur përfundimisht apartamenti është 1.900.000 lekë, vlerë e cila përbëhet nga shuma 12.000 Euro, e paguar përpara marrjes së kredisë dhe nga shuma 400.000 lekë, e paguar ditën e marrjes së kredisë. Pagesa e shumës prej 12.000 euro është bërë në tri faza:
 - a) Ditën e kontratës, më datë 07.06.2007, është paguar shuma 300.000 lekë, e cila është marrë nga pjesa *cash* që ka qenë gjendje në vitin 2007;
 - b) Në datën 18.06.2007 është paguar shuma prej 500.000 lekësh, e vërtetuar nga dokumenti bankar që tregon se është tërhequr shuma prej 494.800 lekë në datë 13.06.2007 nga llogaria e pagës në Raiffeissen Bank.
 - c) Në datë 20.06.2007 është paguar shuma prej 700.000 lekësh, tërhequr nga depozita në emrin tim në Bankën First Investment Bank.Kredia e akorduar në datë 29.06.2007 për blerësin Gentian Trenova ka kaluar në llogarinë e shitësit Sh. H. dhe nga kjo shumë, e cila është tërhequr plotësisht po atë ditë nga ana e saj, është mbajtur vlera prej 400.000 lekësh dhe pjesa tjetër e kredisë së disbursuar është

kthyer mbrapsht në cash. Kjo konfirmohet edhe me deklaratën noteriale të znj. Sh. H., të datës 30.05.2018 me nr. {***} rep., nr. {***} kol.

15. Në lidhje me shtesën 62 m², mbi apartamentin me sipërfaqe 50.6 m², të ndodhur në rr. “{***}”, pall. {***}, sh. {***}, ap. {***}, subjekti i rivlerësimit i përmbahet të gjitha deklaratimeve të bëra para Komisionit në lidhje me dhurimin e apartamentit, shtesës së bërë dhe shpenzimeve të kryera për të, dhe këtë e mbështet edhe përmes deklaratës noteriale të shtetasve L. e H. P., të cilët konfirmojnë se shtesa është bërë nga ana e tyre dhe shpenzimet janë bërë nga të ardhurat dhe kursimet e tyre.
16. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu, pretendon se Komisioni ka shkelur nenet 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, nenet 3, 36, dhe 37 të ligjit nr. 49/2012, pasi subjekti i rivlerësimit nuk është njoftuar paraprakisht për konkluzionin e arritur më parë nga Komisioni dhe as është njoftuar për të drejtën që ka për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me disa nga rezultatet e hetimit kryesisht të Komisionit. Në vendimin përfundimtar të saj Komisioni është shprehur se: “Në fashikullin e akteve të gjendura në dosjen e legalizimit nuk rezultonte të ishte i regjistruar ndonjë akt shkresor, që shprehte miratimin e banorëve të pallatit nr. 65/4, që sipër apartamentit 23 të ndërtohet një kat shtesë, që zinte sipërfaqen e përbashkët të banorëve; fotografitë e objektit nuk i përkisnin objektit të ndërtuar; nuk ishte përcaktuar asnjë pagesë e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, fakt i konstatuar edhe nga Auditimi i Pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe kishte mospërputhje të vitit të ndërtimit të objektit mes periudhës së evidentuar në ekspertizë (viti 2008) dhe asaj që konstatohet nga sistemi *Google Map* (viti 2013). Gjithashtu, u vërejt se e gjithë procedura e aplikimit, këqyrjes së objektit, ekspertimit të tij, shqyrtimit administrativ të kërkesës nga ALUIZNI “Tirana 2” dhe deri te lëshimi i lejes së legalizimit kishte zgjatur vetëm 15 muaj.”
Këto rrethana nuk qëndrojnë dhe nuk janë të sakta. Gjithashtu këto rrethana më janë bërë të njohura vetëm në vendimin përfundimtar dhe nuk është kërkuar asnjëherë sqarim apo pyetje, nuk është pasqyruar as në relacionin paraprak hetimor, është konkluzion i nxjerrë jashtë procesit hetimor administrativ, në shkelje të parimeve bazë të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të Kodit të Procedurës Civile. Mosnjoftimi në lidhje me gjetjen nga ana e Komisionit përbën dhunim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, të KEDNJ-së.
17. Komisioni ka gabuar kur nuk më ka komunikuar në rezultatet e hetimit administrativ faktin e përmendur në vendim në lidhje me “ndërtim të paligjshëm”, duke bërë që procesi të bëhet i pavlefshëm dhe i parregullt ligjor.
18. Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar për fshehje të pasurisë shtesë 62 m², në përdorim, pasi duke deklaruar si adresë banimi këtë pasuri në të gjitha deklaratimet periodike kam ezauruar kërkesat ligjore për deklarim.
19. Në lidhje me dhurimin për shumën 5000 Euro nga vjehrra L. P., kjo shumë është përdorur për shlyerje të pjesshme kredie. Dokumenti bankar llogari e shtetasës L. P. tregon se në muajin prill 2012 është bërë tërheqja nga llogaria e saj, e shumave 500.000 lekë dhe 115.000 lekë. Gjithashtu, H. P. dhe L. P. përmes deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.05.2018 kanë deklaruar se shumat si më sipër, pas tërheqjes nga banka, i janë dhënë në dorë vajzës së tyre (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit).
20. Lidhur me huan në vlerën prej 300.000 lekësh nga motra dhe nëna, në vitin 2012, nga

llogaria bankare e Tirana Bank është tërhequr nga motra, Sh. T., shuma prej 260.270 lekë, ndërkohë që pjesa e mbetur është plotësuar me *cash*. Kjo vërtetohet përmes dokumentit bankar të Banka e Tiranës Sh.A. të datës 11.01.2016, si dhe përmes deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, të motrës Sh. T. që konfirmon dhënien hua të shumës.

21. Lidhur me dhurimet në shumën 1200 euro dhe 25.000 lekë, të dhuruara nga të afërmit, këto të ardhura janë marrë gjatë viteve përpara muajit tetor 2004 vlera e tyre është në vlerë totale pasi shumat janë dhuruar në kohë të ndryshme, nga persona të ndryshëm të afërm dhe në vlera të ndryshme. Personat që kanë kryer dhurimin kanë qenë emigrant në Itali dhe Greqi. Dhuratat janë bërë për gëzime familjare dhe ditëlindje.
22. Komisioni ka gabuar kur ka përllogaritur si shpenzim udhëtimin në Milano në vitin 2007, i cili është bërë për arsye pune dhe shpenzimet janë mbuluar nga institucioni i prokurorisë.
23. Pasuria në pronësi dhe përdorim është 9.000.000 lekë, ndërsa të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes janë rreth 21.000.000 lekë.
24. Në lidhje me kriterin profesional, përfundimet e Komisionit, që i përkasin çështjes penale nr. 287, të vitit 2014, konkluzioni i Komisionit se: *“Hetimi nuk është i plotë si dhe nuk u mbloodhën të gjitha provat e kërkuara për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv; (neni 73.2, Ligji për Statusin nr. 96/2016)”*, është i pabazuar në prova dhe në ligj.
25. Në lidhje me çështjen *“Vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 30.03.2015, për hetim pasuror mbi pasurinë në aktet e referuara me nr. 18, të vitit 2015, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shtetasin V. L., të hetimit të procedimit penal nr. 26, të vitit 2015”*, vendimi për mosfillim të hetimit pasuror është plotësisht i ligjshëm dhe i arsyeshëm.

II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

6. Trupi gjykues e shqyrtoi çështjen në tërësi së bashku me ankimin e subjektit të rivlerësimit në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 49, të ligjit nr. 49/2012. Subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova, duke qenë kandidat për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, në bazë të nenit 284, të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *me përparësi*.
7. Nga aktet e administruara ne dosje bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 17.11.2017, raportin lidhur me vlerësimin e pasurisë, ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurisë, ka kryer deklaram të rremë, si dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Komisioni me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, ka kryer hetim administrativ të thellë për tri kriteret e parashikuara në nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Vendimin e shkarkimit të subjektit Komisioni e ka marrë për dy kritere, të pasurisë dhe të vlerësimit të aftësive profesionale. Për kriterin e figurës, parashikuar nga neni 4, pika 1, germa "b", Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Lidhur me kriterin e pasurisë së subjektit e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton sa vijon:

8. Nga aktet e administruara në dosje nga Komisioni, ka rezultuar e provuar se, subjekti i rivlerësimit Gjentian Trenova, ka qenë subjekt deklarues pasurie prej vitit 2004 deri në vitin 2017 (*vetting*).

Në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit Gjentian Trenova ka deklaruar:

- i. Depozitë bankare në shumën 100.000 lekë në emrin F. T..
- ii. Shtëpi banimi 1+1, rruga “{***}”, pallati {***}, ap {***}, vlera 3.500.000 lekë, e blerë në vitin 1992. Pjesa që zotërojnë është E. T. 1/3, F. T. 1/3 dhe Sh.T. 1/3 të kësaj pasurie.
- iii. Shuma 800.000 lekë në emrin Gjentian Trenova, 2002-2004. Kjo shumë e kursyer nga puna dhe bursa e tij.
- iv. Shuma 500.000 lekë kursime familjare që nga viti 1995 e deri në vitin 2004.

Në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Depozitë në shumën 100.000 lekë në “Bankën e Parë të Investimeve”. Në emrin e F. T..
- ii. *Overdraft* në emrin Gjentian Trenova, në shumën 120.000 lekë pranë Raiffaisen Bank Sh.a.

Në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Depozitë në shumën 700.000 lekë, Banka e Parë e Investimeve, në emër të z.Gjentian Trenova.
- ii. Depozitë 100.000 lekë në emër të zj.F. T.
- iii. Dhurata 25.000 lekë nga e ëma e subjektit, zj.F. T.

Në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Apartament banimi me sipërfaqe 50 m², i blerë në muajin qershor – korrik të vitit 2007, në shumën 1.9 milion lekë. Pjesa takuese, 100%. (*Subjekti në këtë rubrikë nuk është shprehur për burimin e krijimit të kësaj pasurie*).
- ii. Kredi e marrë në shumën 28.000 Euro pranë Alpha Bank Sh.a., me afat maturimi 15 vite, me interes, 5.7 % në vit, kësti mujor për pesë vitet e para, ka qenë 232 euro. *Subjekti në këtë rubrikë nuk është shprehur se për çfarë do të merret kjo kredi.*

Në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Depozitë e përbashkët në shumën 4,000 euro pranë bankës NBG Albania Sh.A., në emrat e Gjentian Trenovës dhe F. T.

Në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Depozitë në bankën “Credins”, hapur në muajin dhjetor të vitit 2010, në shumën 500.000 lekë.

Në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Pagimi i kredisë së shtëpisë në bankën Alpha Bank në vitin 2007, për vitin 2010. Shuma e kredisë së marrë është 28.000 euro.
- ii. Shuma 500.000 lekë marrë në bankën Credins dhe kalimin e kësaj shume në llogarinë e pagës.
- iii. Shuma në vlerë 7350 euro. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo shumë është marrë nga llogaria e pagës ku përfshihet edhe shuma e kaluar nga depozita, si dhe nga kredia e marrë në Alpha Bank.
- iv. Automjet “Benz”, viti i prodhimit 2000, në pronësi të bashkëshortes J. P., i fituar përpara martesës, vlera 2500 euro.

Në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Shlyerje e plotë e kredisë në Alpha Bank, e marrë në shumën 28.000 euro në vitin 2007. Të ardhurat për shlyerjen, sipas subjektit të rivlerësimit, kanë qenë nga paga e tij dhe e bashkëshortes, të kaluara nga viti 2011 deri në 2012 në vlerën 3000 euro. Të ardhura nga dhurimi i vjehrrës së tij në shumën 5000 euro. Këto të ardhura të vjehrrës së tij kanë burim nga vendimi nr.129, datë 22.02.2012, i Këshillit të Ministrave për shpronësimet në interes publik të pronave të paluajtshme për ndërtimin e Unazës së Madhe, Tiranë.
- ii. Marrje kredie në shumën 600.000 lekë në bankën Credins me afat 3-vjeçar.
- iii. Një hua në shumën 300.000 lekë nga familjarët e mi. Të ardhurat kanë qenë të depozituara në Banka Tirana.
- iv. Shlyerje e plotë e kredisë në shumën 7430 euro në Alpha Bank.
- v. Kalimin e pronësisë së apartamentit me kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, shtetasve L. P. dhe H. P., me noter J. Zh.

Në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Shlyerje e plotë e kredisë në Bankën Credins në vitin 2013 në shumën 600.000 lekë.

Në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Depozitë në shumën 3000 euro në bankën Credins, e hapur në datë 13.08.2014. Burimi: të ardhurat nga kursimet e mbledhura nga viti 2013 dhe në vazhdim në llogarinë e pagës.

Në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Shtesë në depozitën e kursimit në vlerën 4000 euro në bankën Credins, e hapur në datë 13.08.2014. Kjo shtesë është vendosur në muajin gusht 2015, e cila ka si burim të ardhura nga paga (kursime).
- ii. Depozitë kursimi në bankën Credins në shumën 3000 dollarë, e hapur më datë 15.01.2015. Të ardhura nga kursimet e pagës.
- iii. Gjendja CASH në shumën 600.000, e akumuluar ndër vite.

Në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- i. Shtesë në depozitën e kursimit në bankën Credins në vlerën 4000 euro, e hapur në datë 13.08.2014. Shtesa është vendosur në datë 15.08.2016. Të ardhurat janë nga kursimet e pagës. Vlera në muajin gusht të vitit 2016 është 11.074 euro së bashku me interesat.
- ii. Blerje automjeti tip Volkswagen në vlerën 1.468.800 lekë, e blerë në datë 30.11.2016. Burimi është tërheqje e depozitës së kursimeve në Credins në vlerën 11.000 euro.
- iii. Depozitë kursimi në shumën 3000 euro në bankën Credins, e hapur në datë 01.02.2016. Burimi: kursime të pagës.
- iv. Gjendja CASH e akumuluar ndër vite në fund të muajit dhjetor të vitit 2016 është 500.000 lekë.

Në vitin 2017 (vetting), subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë ka deklaruar:

- i. Apartament banimi në shumën 1.900.000 lekë, i blerë në muajin qershor, viti 2007, me sipërfaqe 50 m², me adresë rr. “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, apartamenti {***}, Tiranë. Burimi: blerë në bazë të kredisë, të marrë në bankën Alpha Bank në vitin 2007. Apartamenti ka ndryshuar pronësi në muajin nëntor të vitit 2012, me dhurim personave të tjerë. Pjesa takuese ka qenë 100%.
- ii. Automjet tip “Benz”, vlerën 2500 euro. Burimi i fituar me kontratë dhurimi nga prindërit e bashkëshortes përpara martesës. Ky automjet është në pronësi të bashkëshortes së subjektit J. P.

- iii. Depozitë në vlerën 3.058 dollarë amerikanë në emër të subjektit të rivlerësimit Gentian Trenova. Burimi: kursime nga paga.
 - iv. Automjet tip Volkswagen në vlerën 1.468.800 lekë. Burimi janë tërhequr në depozitën e kursimit në bankën Credins në llogarinë e subjektit në vlerën 11.000 euro të kursyera nga paga.
 - v. Depozitë në Bankën Credins në vlerën 3000 euro, pjesa takuese 100%, në emër të subjektit Gentian Trenova. Burimi kursime nga paga.
 - vi. Gjendje në llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit Gentian Trenova, datë 20.01.2017, në vlerën 478.257 lekë.
 - vii. Gjendja në llogarinë e pagës së bashkëshortes së subjektit J. P. në datë 20.01.2017, në vlerën 14.072 lekë.
 - viii. Gjendja në CASH shuma 500.000 lekë deri në datën e deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017.
 - ix. Detyrime prej 300.000 lekë, marrë nga motra dhe nëna e subjektit në vitin 2012 e pa shlyer. Burimi në bazë të kursimeve familjare ndër vite. Kjo vërtetuar nga dokumenti i bankës “Tirana Bank”.
9. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, lidhur me arsyetimin ligjor për vlerësimin e kriterit të pasurisë, parashikuar nga neni 4, pika 1/a e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Gentian Trenova, arsyeton si më poshtë:
10. *Pasuria nr. 1*, apartament me sipërfaqe banimi 50 m², me adresë rr. “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, ap. {***}, kati {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 ka deklaruar, vlerën 1.900.000 lekë, i blerë në muajin qershor, viti 2007; Burimi: blerë në bazë të kredisë së marrë në bankën Alpha Bank në vitin 2007. Apartamenti ka ndryshuar pronësi në muajin nëntor të vitit 2012, me dhurim personave të tjerë. Pjesa takuese ka qenë 100%.
11. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje nga Komisioni, ka rezultuar e provuar se: Kjo pasuri nga subjekti është deklaruar në dy momente. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2007 dhe në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017.
- Burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017 është: blerë nga kredia e marrë në bankën Apha Bank në vitin 2007, kurse në deklaratën e pasurisë të vitit 2007 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim, por ka deklaruar vetëm apartament me sipërfaqe 50 m².*
- Vlera e kësaj pasurie, në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017 është 1.900.000 lekë, vlerë e cila është e njëjtë me deklaratën e pasurisë të vitit 2007.*
12. Nga shqyrtimi gjyqësor, trupi gjykues në bazë të akteve shkresore të administruara në dosje arrin në përfundimin se për këtë pasuri ekzistojnë dy kontrata: e para, kontratë shitje me rezervë pronësie, me noter R. S., e cila mban datën 07.06.2007, ku çmimi i pasurisë/apartamentit rezulton të jetë 40.000 euro dhe kontrata tjetër, e cila mban datën 27.06.2007, lidhur mes të njëjtave palë shitëse dhe blerëse dhe vlera e pasurisë/apartamentit është 1.900.000 lekë. Të dyja kontratat janë formuluar përpara të njëjtit noter, konkretisht noterit R. S. Gjithashtu, lidhur me këtë pasuri, ka dhe një kontratë dhurimi të datës 21.11.2012, ku në cilësinë e dhuruesit është subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova dhe pranues i këtij dhurimi janë shtetasit, H. P. dhe L. P., njëkohësisht prindërit e bashkëshortes së tij.
13. Kontrata e shitjes me rezervë është mbajtur përpara noterit me datë 07.06.2007, në të cilën është konstatuar se vlera e apartamentit është 40.000 euro dhe është likuiduar në këtë mënyrë: Vlera

12.000 euro është likuiduar nga subjekti përpara nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pjesa tjetër prej 28.000 euro do të likuidohej nga subjekti tek shitësit në momentin e marrjes së kredisë bankare pranë Alpha Bank.

14. Në kontratën e shitblerjes me rezervë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2007, paragrafi 7 i saj parashikohet se shuma prej 12.000 eurosh është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Nga analiza ekonomike e bërë në Kolegj për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme, të disponueshme të njësisë ekonomike familjare “Trenova” për të paguar shumën 12.000 euro, të cilën subjekti e ka deklaruar të paguar përpara datës së nënshkrimit të “Kontratë Shitje me Rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2007, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, nuk justifikojnë me të ardhurat e ligjshme, pagesën paraprake në shumën 12.000 euro të çmimit 40.000 euro të pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 50.6 m² të përcaktuar në kontratën më sipër. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit nga data 01.01.2007 deri më 01.06.2007, kanë qenë në vlerën 512,615 lekë. Gjendja në fillim të periudhës, pra më 01.01.2007, ka qenë 802,247 lekë (700,000 lekë, teprica e depozitës në Fibank Sh.A., dhe 102,247 lekë, teprica e llogarisë së pagës në Raiffeisen Bank Sh.A.). Trupi Gjykues vlerëson se është i drejtë vendimi i Komisionit kur i merr në konsideratë subjektit të rivlerësimit shumën prej 700.000 lekësh, tërhequr nga banka më datë 18.06.2007, sepse për disa ditë mund të përdorte gjendjen *cash* (gjendja *cash* është 800.000 lekë, të cilën subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna para ILDKPKI më datë 14.01.2018 deklaroi t’u ketë shpenzuar të gjithën për martesë në vitin 2011) dhe t’u zëvendësonte me tërheqjen nga banka. Teprica e llogarisë së pagës pas pagimit të detyrimit, pra më 11.06.2007, ka qenë në vlerën 504,835 lekë. Në zërin shpenzime, janë përfshirë: shpenzimet familjare sipas INSTAT për periudhën pesë mujore (01.01.2007 – 01.06.2007), në vlerën 131,540 lekë, parapagim për blerje apartamenti banimi me sipërfaqe 50.6 m² në vlerën 1,491,600 lekë (12.000 euro konvertuar me kursin e këmbimit më 07.06.2007, 124.30 ALL/EUR, sipas të dhënave të marra nga arkiva e kurseve të këmbimit publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë) dhe kostot e shpenzimeve për udhëtime jashtë kufijve të vendit, në vlerën 37.087,38 lekë. Rezultatet e përlllogaritjeve, provojnë se njësia ekonomike familjare “Trenova” nuk justifikon likuidimin e shumës 12.000 euro, ose 1.491.600 lekë në shumën 850.200 lekë [(802.247 lekë + 512.615 lekë) – (504.835 lekë + 131.540 lekë + 1.491.600 lekë + 37.087,38 lekë) = - 850.200 lekë]. Në arsyetimin e kundërshtimeve të subjektit ndaj konstatimeve të Komisionit në lidhje me pagimin e shumës 12,000 Euro, janë marrë në konsideratë faktet më poshtë:

- i. Shuma 800.000 lekë, e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2004 *e kursyer nga puna dhe bursa* e subjektit për periudhën 2002-2004 (deklarimi i pasurisë i vitit 2004, pika iii) rezultojnë të ketë qenë e pandryshuar, gjendje *cash*, deri në vitin 2011 referuar procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI më 14.01.2016, ku kërkesës së këtij institucioni për të konfirmuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2014, subjekti i është përgjigjur: “disponoj vetëm 600.000 lekë të bashkëshortes, pasi gjendjen e deklaruar prej 800.000 lekësh e kam shpenzuar për martesë”, pra në vitin 2011. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se kursimet në shumën 800.000 lekë, nuk janë përdorur për likuidimin paraprak të çmimit të apartamentit të banimit 50.6 m², në shumën 12.000 euro.
- ii. Nga shqyrtimi i hollësishëm i deklaratave periodike dhe dokumentacionit bankar, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se shuma 300.000 lekë, kursime *cash*, nuk është përdorur për likuidimin paraprak të çmimit të apartamentit të banimit 50.6 m², në shumën 12,000 Euro, pasi nuk rezultojnë të jenë deklaruar kursime në këtë shumë në asnjë deklaratë periodike, apo të jetë kryer pagesë me rrugë bankare në këtë shumë deri më 07.06.2007.

- iii. Subjekti i rivlerësimit, prej vitit 2005 e në vijim, nuk rezulton të ketë deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve në banesë apo në bankë. Ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2015, gjendje *cash* në shumën 600.000 lekë, të akumuluar ndër vite, dhe në deklaratën periodike të vitit 2016, gjendja *cash* e akumuluar ndër vite, në fund të muajit dhjetor të vitit 2016, është 500.000 lekë.
- iv. Në lidhje me shumën 494.800 lekë, të tërhequr nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank Sh.A., më datë 13.06.2007, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se kjo shumë nuk është përdorur për likuidimin paraprak të çmimit të apartamentit të banimit me sipërfaqe 50.6 m², në shumën 12.000 euro (ose 1.491.600 lekë) si pretendon subjekti, pasi referuar kontratës së shitjes me rezervë, ky transaksion është kryer *cash*, deri më 07.06.2007, pra gjashtë ditë përpara datës së tërheqjes së kësaj shume nga llogaria e pagës në bankën më sipër.
15. Trupi gjykues i Kolegjit, ka vlerësuar pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, të ligjshme, të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, për të blerë pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe 50.6 m², me numër pasurie {***}, zona kadastrale {***}, rr. “{***}”, ap. {***}, me çmimin 40.000 euro të specifikuar në “Kontratë Shitje me Rezervë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2007, likuiduar *cash* shuma 12.000 euro deri më 07.06.2007, dhe shuma 27.710 euro, financiar nga Alpha Bank Sh.A.
- Rezultatet e analizës financiare tregojnë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, të ligjshme për të justifikuar rritjen e asetëve dhe shpenzimet për vitin 2007. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, nuk justifikojnë me të ardhurat e ligjshme, pasurinë e krijuar dhe shpenzimet e kryera, në shumën 1.677.343,73 lekë.
16. Referuar kontratës nr. {***}, datë 15.06.2007, “Për kufi kredie shumë qëllimor”, mes subjektit Gentian Trenova dhe bankës Alpha Bank-Albania është kryer çelja e kufirit të kredisë nga banka në kufirin e kredisë në shumën 31.500 euro.
- Referuar kontratës nr. {***}, datë 15.06.2007, “Kontrate Huaje” mes palëve shoqërisë Alpha Bank-Albania dhe subjektit Gentian Trenova, konstatohet se shuma prej 28.000 euro është përdorur nga subjekti për blerje apartamenti në Tiranë. Nga kjo kontratë konstatohet se nga subjekti është paraqitur në bankë projekti i blerjes së një apartamenti të ndodhur në Tiranë. Projekti (apartamenti) ka një vlerë/kosto të përgjithshme prej 40.000 euro. Kontributi i kredimarrësit/subjektit të rivlerësimit në financimin e projektit/apartamentit është 12.000 euro ose 30% e kostos së përgjithshme të apartamentit. Pjesa tjetër e kostos së përgjithshme të apartamentit prej 28.000 euro ose 70% e tij është kërkuar të financohet nga banka, e cila ka pranuar të financojë këtë shumë në këtë projekt/likuidim vlere për blerje të apartamentit.
17. Pra, nga interpretimi i kësaj kontrate huaje, qëllimi i kredisë së marrë nga subjekti shpreh qartë destinacionin e shumës 28.000 euro për blerje apartamenti dhe njëkohësisht e vërteton faktin se pasuria apartament është blerë sipas kontratës së datës 07.06.2007, ku vlera e apartamentit është 40.000 euro.
18. Nga shqyrtimi i praktikës bankare (lëvizjes së llogarisë nr. {***} të subjektit, printuar më 08.12.2015), përcjellë nga Alpha Bank Sh.A., me shkresën nr. {***} prot., datë 29.01.2018, konfirmohet se shuma 27.710 euro është transferuar në llogarinë e shitësve të apartamentit 50.6 m², me përshkrimin: “nga Gentian Trenova për Sh. e A. H./ pagesë sipas kontratës nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 07.06.2007”. Menjëherë pas disbursimit të kredisë, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, në shumën 1.900.000

lekë. Nga kontrolli i llogarive të subjektit të rivlerësimit, apo edhe të palës shitëse, nuk rezulton të jetë mbajtur shuma 400.000 lekë dhe diferenca (24.286 euro) të jetë kthyer mbrapsht te blerësi, si pretendon subjekti në ankim. Më 30.06.2007, subjekti është pajisur me certifikatë pronësie për apartamentin nr. 23 më sipër, e regjistruar me vlerën 1.900.000 lekë, sipas kontratës së shitjes, e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

19. Gjithë sa më sipër, janë vërtetuar nga kontrata e shitjes me rezervë e datës 07.06.2007, ku vlera e këtij apartamenti është 40.000 euro dhe mënyra e likuidimit e përcaktuar në këtë kontratë vërtetohet me dokumentet bankare dhe procedurat e kryera pranë bankës Alpha Bank nga subjekti Gentian Trenova.

Lidhur me kontratën e shitjes, e cila mban datën 27.06.2007, mes subjektit të rivlerësimit dhe shitësve A. H. dhe Sh.H. për të njëjtin apartament në vlerën 1.900.000 lekë, për regjistrimin e këtij apartamenti në ZVRPP Tiranë, trupi gjykues çmon se kjo kontratë është përdorur nga subjekti për të fshehur burimin e krijimit të kësaj pasurie. Pra trupi gjykues vlerëson se kjo kontratë është një kontratë shitje fiktive pasi është lidhur pas kontratës së shitjes me rezervë, ku kjo e fundit i kishte sjellë tashmë të gjitha pasojat juridike, pasi pagesa e çmimit ishte kryer plotësisht.

20. Kontrata e datës 27.06.2007, e cila mban vlerën 1.900.000 lekë, është përdorur nga subjekti i rivlerësimit për regjistrimin e kësaj pasurie në ZVRPP Tiranë.
21. Lidhur me deklaratën noteriale të znj. Sh. H., në cilësinë e shitëses së apartamentit, për momentin kur deklaroi se i ka kthyer mbrapsht subjektit të rivlerësimit shumën prej rreth 24.000 euro të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe të disbursuar në llogarinë e saj bankare, nga analiza e provave të gjendura në dosje, vlerësojmë se nuk ekziston asnjë dokument bankar dhe/ose financiar apo akt noterial i kohës kur pretendohet të jetë kthyer kjo shumë, që të vërtetojë kalimin e kësaj shume tek subjekti i rivlerësimit, e për rrjedhojë nuk justifikohet as rikonstrukcioni i apartamentit në vlerën prej 13.000 euro, deklaruar nga subjekti që të jetë bërë me këto të ardhura.
22. Në përfundim subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova nuk justifikon burimin e ligjshëm për blerjen e këtij apartamenti, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të kësaj pasurie, sipas nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, sipas nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës.

23. Këto sa sipër vërtetohen në bazë të provave të administruara në dosje që janë:

- i. Shkresa e “Alpha Bank” nr. {***} prot., datë 29.01.2018, regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 30.01.2018, e cila konfirmon likuiditetet e subjektit, personave të lidhur, si dhe personave të tjerë të lidhur, si dhe disponimin e plotë të akteve lidhur me kredinë e marrë.
- ii. Shkresa nr. {***} prot., datë 01.02.2018, e ZVRPP Tiranë, me anë të së cilës është dërguar praktika për pronësinë e këtij apartamenti, brenda kësaj praktike është dhe kontrata e shitjes e datës 27.06.2007, me vlerë 1.900.000 lekë.
- iii. Shkresa e noteres E. S. H. me nr. {***} prot., datë 26.02.2018, të Komisionit, e cila mundësoi praktikën shkresore që i përket nënshkrimit të kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, me vlerë 40.000 euro.
- iv. Procesverbali i anketimit, datë 14.01.2016 dhe 22.01.2016, përpara ILDKPKI-së, ku subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaramet e tij për këtë pasuri.
- v. Deklarata noteriale e znj. Sh. H., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}.

24. *Pasuria nr. 2* - Shtesë kati mbi apartamentin me sipërfaqe banimi 50 m², me adresë rruga “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, ap. {***}, kati {***}, Tiranë.

Trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri, në bazë të provave të administruara në dosje, konstaton se:

- Nuk është deklaruar kjo pasuri në deklaratat e periodike të pasurisë nga subjekti Gentian Trenova.
- Kjo pasuri/shtesë apartamenti është bërë e njohur nga një denoncim anonim i bërë pranë ILDKPKI-së, i cili mban nr. {***} prot., datë 20.11.2017.
- Sipas provave/dëshmimeve është provuar që është ndërtuar në vjeshtën e vitit 2012.
- Për këtë pasuri është provuar se nga krijimi i saj dhe deri më sot aty banon subjekti me familjen e tij dhe jo shtetasit L.e H. P., të cilëve iu është dhuruar pasuria (pasuri nr. 1 e vendimit)
- Me shkresën e OSHEE Sh.A.-së, nr. {***} prot., datë 18.01.2018, si dhe me procesverbalin e verifikimit nr. {***}, datë 08.01.2018, konfirmohet se kjo pasuri/dubleks furnizohet vetëm me një kontratë energjie elektrike dhe ka si titullar të saj subjektin e rivlerësimit Gentian Trenova.
- Me shkresën zyrtare të UKT-së, nr. {***} prot., datë 25.01.2018, konfirmohet se pasuria/dubleks furnizohet vetëm me një kontratë shërbimi ujësjellës-kanalizim nr. {***} dhe ka si titullar të saj subjektin e rivlerësimit Gentian Trenova.
- Me shkresën zyrtare të ZVRPP-së, nr. {***} prot., datë 01.02.2018, si dhe dokumentacioni shoqërues bashkëlidhur, pjesë e fashikullit të provave prezantohet historiku i zhvillimit të pasurisë që i përket ap. {***}, p. {***}, rr. “{***}”. Me anë të kësaj shkrese, informohet se shtesa e katit mbi apartamentin nr. {***}, p. {***}, kati i {***}, rr. “{***}”, Tiranë, është regjistruar si pasuri më vete, si dhe të gjitha veprimet dhe formalitetet administrative janë nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova.
- Me shkresën e Drejtorisë së ALUIZNI-t “Tirana 2” nr. {***} prot., datë 09.02.2018, konfirmohet se shtesa e katit {***}, sipër ap. {***} në p. {***}, në rr. “{***}”, Tiranë, është legalizuar me lejen e legalizimit nr. {***}, datë 25.09.2014. Nga ky institucion u sigurua informacioni se aplikues (vetëdeklarues) të përfshirjes në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje janë shtetasit H. dhe L. P. (sipas kërkesës nr. {***} prot., datë 26.06.2013).
- Me shkresën e Drejtorisë së ALUIZNI-t “Tirana 2”, nr. {***} prot., datë 25.01.2018, jepet informacion mbi aplikimin e nënshkruar nga bashkëshortët, shtetasit H. dhe L. P., si dhe dokumentacioni që disponohet nga ky institucion për këtë praktikë.
- Me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, subjekti i rivlerësimit i dhuron shtëpinë prej 50 m², në rr. “{***}” personave të lidhur H. dhe L. P.
- Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë rezultuan dyshime të arsyeshme për këtë pasuri.
- Është konstatuar se subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri ka shprehur se është pronë e prindërve të bashkëshortes dhe ai e ka poseduar gjithmonë këtë. Ai pretendon se shpenzimet dhe gjithçka e lidhur me këtë pasuri janë të shtetasve H. dhe L. P.
- Me deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, H. dhe L. P. deklarojnë se shtesa është kryer nga vetë ata dhe me shpenzimet e tyre.

26. Gjithashtu, në përgjigjet shtesë që subjekti i rivlerësimit i kthen më datë 08.03.2018 pyetjeve të Komisionit¹, ai deklaron: “punimet për shtesën janë bërë pas dhurimit të pronës...”, “Shpenzimet në lidhje me shtesën e bërë, janë bërë nga kursimet dhe të ardhurat e prindërve të bashkëshortes. Këto shpenzime kapin një vlerë të përafërt prej 1.5 deri në 2 (dy) milionë lekë”, dhe në përgjigjet kthyer pyetjeve të Komisionit² më 05.03.2018, deklaron: “...gjatë periudhës 2012-2013 unë kam banuar në këtë apartament (50.60 m², dhuruar në nëntor të vitit 2012 prindërve të bashkëshortes), me shkëputje të vogla ditore për shkak të punimeve”. Në kthim përgjigje shtesë, më datë 16.03.2018, subjekti deklaron: “...punimet kanë filluar në vitin 2012, si muaj të saktë nuk e kujtoj por nga vjeshta e këtij viti.”

27. Trupi gjykues lidhur me këtë pasuri/shtesë të apartamentit, pasi shqyrtoi faktet si më sipër në harmoni me -

1. të ardhurat nga qiraja sipas kontratës së qirasë nr. {***}, datë 12.02.2007, me Njësinë Bashkiake nr. 9, Tiranë, si rezulton nga përshkrimi i transaksioneve bankare (CD Raiffeisen Bank);
2. të ardhurat e arkëtuara nga kompensimi për shpronësim, vendimi nr. 129, datë 22.02.2012 i Këshillit të Ministrave;
3. të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit nr. 7185, datë 25.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë -

si dhe pasi analizoi:

1. hyrje-daljet (debi – kreditë / *cash flow*) e dokumentuara në “lëvizjet e llogarive”, sjellë nga bankat me të cilat H. P. dhe L. P. kanë mbajtur llogari bankare;
2. të ardhurat nga pagat e H. P. dhe L. P., sipas vërtetimeve të sjella: nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik për L. P. për periudhën 03.05.1993-26.03.2018) dhe nga Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë për H. P., prej datës 01.01.1994-31.03.2017.
3. destinacionin e përdorimit të të ardhurave të H. dhe L. P., për periudhën, prej datës 21.11.2012³ deri në datën e deklarimit të shtesës, më 26.06.2013⁴.

28. Trupi gjykues vlerëson se është i drejtë vendimi i Komisionit kur konkludon se personat e lidhur H. dhe L. P. nuk justifikonin me burime të ligjshme kostot për ndërtimin e shtesës së katit në apartamentin në rr. “{***}”, si dhe rikonstruksionin e tij, pasi nuk vërtetohej se kishin shpenzuar nga të ardhurat dhe kursimet e tyre për këtë ndërtim.

Fondet e përfituara nga vendimi nr.129, datë 22.02.2012, i Këshillit të Ministrave dhe vendimit nr. 7185, datë 25.06.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë përdorur:

- për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 64.20 m² me numër pasurie nr. {***}, z.k. {***}, vol. {***}, fq. {***}, në L. “{***}”, P. {***}, Sh. {***}, K. {***}, Ap. {***}, {***}, Kavajë;
- për investim në letra me vlerë, bono thesari.

29. Lidhur me mos deklarimin e kësaj pasurie në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka fshehur pasurinë në përdorim që në momentin e krijimit të saj. Kalimi i apartamentit të tij (pasuri e parë në vendim) me kontratë dhurimi të njëjtëve persona

¹ e-mail datës 05.03.2018, (fash.11/3, fq.2245)

² e-mail i datës 03.04.2018

³ Data e kalimit të pronësisë me sip.50.60 m², Nr. {***}, Z.K. {***}, P. {***}, Sh. {***}, K. {***}, Ap. {***}, Tiranë me Kontratën e Dhurimit nr. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.11.2012.

⁴ Praktika e Legalizimit me nr.289 prot, datë 26.03.2013, për legalizimin e “shtesës së katit” me sipërfaqe 62.90 m²

dhe fillimi i ndërtimit të shtesës në të njëjtën kohë dhe aplikimi në ALUIZNI në emrin e këtyre të fundit vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka fshehur burimin e të ardhurave për krijimin e këtyre pasurive (apartament banimi dhe shtesë).

30. Bazuar në nenin 4, germa “a” të ligjit nr. 9049, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të deklarojë të gjitha të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme sipas Kodit Civil. Referuar kontratës së dhurimit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, sipas nenit 2 dhe 3 të kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit ka ruajtur të drejta reale mbi këtë pasuri, pasi e ka ngarkuar dhurimin me barrën/kushtin e përdorimit pa kufizim në kohë të apartamentit, të drejta reale këto, të pa deklaruara në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017 dhe as në deklaratimet periodike të pasurisë ndër vite.
31. Për gjithë sa sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit:
 - i. Ka kryer fshehje të pasurisë së paluajtshme, në përdorim (të ndërtimit shtesë kati, e përshtatur si njësi banimi e integruar).
 - ii. Ka kryer deklaram të rremë, lidhur me përdorimin e burimeve të ligjshme për realizmin e ndërtimit të shtesës së katit.
 - iii. Ka ndërmarrë veprime juridike fiktive, lidhur me dhurimin me kusht të apartamentit me sipërfaqe 50 m², në rr. “{***}”, drejt personave të tjerë të lidhur (vjeherri/vjehrra), me qëllim dhënien e imazhit të rremë të zhveshjes nga pronësia e për pasojë, shkarkimin nga përgjegjësia përkatëse për veprimet e mëtejshme, pasi nga provat dhe faktet rezultojnë se ka qenë e vijon të jetë i vetmi posedues efektiv në këtë pasuri. Veprimet e tij cenojnë pastërtinë e figurës dhe etikës së magjistratit.
32. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të kësaj pasurie, sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.
33. *Pasuri nr. 3. Dhurime dhe hua.*
 - a. Dhurim në prill të vitit 2012, në shumën 5.000 euro, nga prindërit e bashkëshortes.
 - b. Dhurime në shumën 1.200 euro dhe 25.000 lekë të dhuruara nga të afërmit.
 - c. Hua në shumën 300.000 lekë të dhëna nga motra dhe nëna në vitin 2012.
34. Për dhurimin e shumës 5000 Euro nga vjehrra, L. P., shprehemi se nga analiza e provave të gjendura në dosjen e gjykimit, megjithëse rezultojnë që shtetesja L. P. të ketë kryer tërheqje nga llogaria bankare dy herë, 500.000 lekë dhe 115.000 lekë, nuk ka asnjë dokument financiar apo ligjor, përmes të cilit subjekti i rivlerësimit të vërtetojë marrjen e kësaj shume nga vjehrra e tij.
35. Sa i takon deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, të vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, L. P., vlerësojmë se kjo deklaratë duhet të ishte bërë në momentin e dhurimit në mënyrë që të merret në konsideratë nga trupa (pasi në atë periudhë ka qenë detyrim ligjor).
36. Për dhurimin në vlerën 1200 euro, trupi gjykues vlerëson se ky deklaram nuk ka asnjë dokument ligjor që provon kalimin e këtij dhurimi te subjekti.
37. Lidhur me pretendimet e ankuesit për huan në shumën 300.000 lekë nga motra, Sh. T., shprehemi se nga analiza e provave të gjendura në dosjen e gjykimit, megjithëse rezultojnë që motra e subjektit të rivlerësimit të ketë kryer tërheqje nga llogaria bankare në vlerën rreth 260.270 lekë, nuk u gjet asnjë dokument financiar apo ligjor, përmes të cilit subjekti të vërtetonte marrjen e kësaj huaje, dorëzimin e shumës, në atë periudhë që pretendohet të jetë marrë huaja. Kjo hua është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë të vitit 2012, dhe më pas nuk është deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike pasardhëse, për t’u deklaruar si e pashlyer në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017. Për sa sipër nuk mund të merret në konsideratë si ardhur e ligjshme e subjektit. Sa i takon

deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë {***}, të motrës së subjektit të rivlerësimit, Sh. T., vlerësojmë se kjo deklaratë duhet të ishte bërë në kohën e dhurimit, pasi në vitin 2012 ka qenë detyrim ligjor i subjektit deklarues në mënyrë që të merret në konsideratë nga trupi gjykues.

38. Si rrjedhojë e kësaj analize sa sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga subjekti i rivlerësimit nuk janë shpjeguar bindshëm burimi i krijimit të këtyre të ardhurave sa sipër në përputhje me nenin “D” pika 3, e Aneksit të Kushtetutës.

Analiza ligjore për vlerësimin e aftësive profesionale nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit:

39. Siç u analizua edhe më sipër, Komisioni në vendimin e tij ka dalë në konkluzionin e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, jo vetëm për kriterin e pasurisë, por edhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar kjo në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
40. Rivlerësimi i kriterit etiko-profesional nga Komisioni është kryer në bazë të nenit 40 e vijues të ligjit nr. 84/2016 në mënyrë të pavarur mbi dosjet e përzgjedhura me short.
Çështjet e vlerësuara nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit Gentian Trenova janë:
1. *Çështja nr. 1* - Vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 30.03.2015, për hetim pasuror mbi pasurinë në aktet e referuara me nr. 18, të vitit 2015, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shtetasin V. L..
 2. *Çështja nr. 2* - Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. 287/2014, i datës 04.03.2016.
41. *Çështja nr. 1* - Vendimi për mosfillimin e procedimit penal, datë 30.03.2015, për hetim pasuror mbi pasurinë në aktet e referuara me nr. 18, të vitit 2015, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shtetasin V. L.
42. Ky procedim për hetim pasuror është regjistruar bazuar në materialin referues të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, më datë 22.09.2014. Me vendimin e datës 30.03.2015, është vendosur mosfillimi i hetimit pasuror, nga subjekti i rivlerësimit, pasi nga shqyrtimi i të dhënave të mbledhura, nuk kishte rezultuar që shtetasi V. L., ose personi i lidhur me të, të ketë në pronësi ndonjë pasuri tërësisht të pajustificuar, e cila mund të konsiderohet si e ardhur nga veprimtari të paligjshme.
43. Sipas dokumenteve të dosjes gjyqësore vihet re që, në shkresën e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastër, Seksioni i Hetimit të Aseteve Kriminale, për referimin e veprës penale datë 30.04.2013, evidentohet shkresa nr. {***} prot., datë 27.05.2007, e Drejtorisë së Luftës Kundër Krimit të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas së cilës, shtetasi V. L. (identifikuar me të dhënat personale përkatëse) ishte ndaluar nga Policia e Janinës në Greqi, për shkak se i janë sekuestruar 117 kg e 700 g kanabis sativa, si dhe një pistoletë e tipit “Tokaref”.
44. Seksioni i Hetimit të Aseteve Kriminale pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastër ka nisur verifikimin e të gjitha pasurive të këtij shtetasi, si dhe të personave të lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.
45. Në bazë të të dhënave të siguruara nëpërmjet informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastër me shkresën “Informacion për referimin e veprës penale”, më datë 30.04.2013, është kryer verifikimi pasuror i shtetasit V. L. Nga verifikimet e kryera nga kjo drejtori, janë evidentuar pasuritë e regjistruara në emër të shtetasit V. L. dhe familjarëve të tij, pasuri të

luajtshme dhe të paluajtshme, të rrjedhura nga veprimtaria kriminale e trafikimit të lëndëve narkotike.

46. Gjithashtu, në referimin e veprës penale konstatohet se: “Nga burime konfidenciale ky shtetas disponon prona të tjera të paregjistruara, si dhe llogari bankare që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, të depozituara në banka të ndryshme që operojnë në shtetin shqiptar.”
47. Bazuar në të dhënat e siguruar si më sipër është regjistruar fillimi i hetimit pasuror në ngarkim të shtetasit V. L., dhe familjarëve të tij; lëshimi i urdhrave për hetimin e mjeteve financiare, të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale.
48. Në përfundim të verifikimit dhe hetimit pasuror paraprak, me shkresën përcjellëse nr. {***} prot., datë 30.04.2013, Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastër ka dërguar materialet procedurale në Prokurorinë për Krimet e Rënda, ku subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova është caktuar prokuror i çështjes.
49. Me urdhrin e datës 29.09.2014, subjekti i rivlerësimit, Gentian Trenova ka urdhëruar të verifikohen të gjitha asetet e mundshme të padeklaruara që zotëron shtetasi V. L., duke lënë afatin 25.10.2014 për kryerjen e këtyre veprimeve.
50. Për gjithë sa sipër, trupi gjykues vlerëson se, nga subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova nuk është kryer verifikimi i plotë i pasurive, asetëve dhe likuiditeteve në bankë të shtetasit në hetim, nuk është kryer verifikimi i plotë i të gjithë historikut të aktivitetit tregtar, si dhe i pasjes ose mospasjes së kuotave/aksioneve në Regjistrin Tregtar, duke qenë se nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër ka vetëm një përgjigje të shkurtër, që evidenton vetëm faktin se aktiviteti i shtetasit V. L., në kuadër të shoqërisë “{***}” Sh.P.K., me NIPT, {***}, me datë fillimi të aktivitetit, datën 13.05.2010, në atë moment është me status pasiv.
51. Gjithashtu, nuk është kryer verifikimi i plotë i të gjitha transaksioneve të mundshme me veprime noteriale, për investime në pasuri të paluajtshme apo në veprimtari të tjera, duke marrë informacion nga Ministria e Drejtësisë për të dhënat në Regjistrin Noterial Shqiptar, bazuar në VKM-në nr. 304, datë 21.05.2014, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar”, si dhe nuk është kryer verifikimi i plotë i burimeve të të ardhurave dhe mënyrën së jetesës të shtetasit V. L., dhe familjarëve të tij.
52. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë hapat e duhur apo të nevojshëm për të kryer një hetim objektiv.
53. Për sa më sipër, është i drejtë vendimi i Komisionit kur konkludon se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është ndërmarrë logjikisht hetimi, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, në përputhje me nenin 73, pika 2, e ligjit nr. 96/2016.
54. *Lidhur me çështjen nr. 2*, trupi gjykues konstaton si vijon:
Më datë 09.06.2014, Prokuroria e Krimeve të Rënda regjistroi procedimin penal nr. 178/ 2014, për veprën penale të “Trafikimit të personave të rritur”, sipas parashikimeve të nenit 110/a të Kodit Penal ndaj A. R.
55. Në vijim të hetimit është marrë vendim mbi përgjimin e numrit të telefonit të të dyshuarit A. R. Nga ky përgjim, rezulton se më datë 17.10.2014, numri i përgjuar merr një mesazh nga një numër telefoni tjetër, i cili u përcaktua më vonë që ishte në përdorim nga shoku i tij, shtetasi A. L. Nga

përmbajtja e mesazhit rezultonte që i dyshuari A. R. i kishte kërkuar shtetasit A. L. 7.500 euro dhe se ai ishte në probleme. Pas 2 minutash, i njëjti numër dërgoi një tjetër mesazh, duke shkruar: “Beto hem që i kam dhënë prokurorit 4.500 euro në dorë dhe që ai e kishte mbyllur çështjen, por një tjetër e kish rihapur atë, meqenëse personi që godita kërkoj për një rihapje të çështjes...”.

56. Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal më 21.10.2014 është urdhëruar nga Prokurore M. K., regjistrimi i procedimit penal me akuzën e veprës penale të “Korrupsionit aktiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në emër të shtetasit A. L. dhe “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” pa autor të identifikuar, parashikuar respektivisht në nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal.
57. Më datë 23.10.2015 me vendimin “Për zëvendësimin e prokurorit” është bërë zëvendësimi i Prokurores M. K. me Prokuroren E.M., e cila ka vendosur kryerjen e disa veprimeve hetimore.
58. Kalimi i këtij procedimi tek subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova, është bërë më datë 05.01.2016, për arsye të përfundimit të afatit të komandimit të prokurores E.M.
59. Subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova, në relacionin e tij për procedimin penal nr. 287/2014, i cili i është drejtuar drejtuesit të prokurorisë B. T., ka analizuar ndër të tjera se nuk rezultoi e plotësuar figura e veprës penale të regjistruar. Nuk ka asnjë provë direkte apo indirekte që të krijojë idenë se përmbajtja e sms-së së shtetasit A. L. dërguar shtetasit A. R., apo se deklaratimet e shtetasit A. L. para oficerit të policisë gjyqësore të datës 21.10.2015 të jenë të vërteta. Dëshmitë e shtetasit A. L. para oficerit të policisë gjyqësore e datës 21.10.2015 janë konsideruar nga subjekti i rivlerësimit, pasi këto shpjegime janë dhënë pa praninë e avokatit.
60. Më këtë analizë si më sipër, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “a”, të Kodit të Procedurës Penale, për arsye se ka dalë qartë se fakti nuk ka ekzistuar, ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal.
61. Trupi gjykues i Kolegjit pasi analizoi faktet dhe provat e administruara nga organi i prokurorisë dhe Komisioni, arriti në konkluzion, se nuk është bërë hetim i plotë i çështjes, pasi nga subjekti i rivlerësimit nuk janë kryer veprime hetimore të logjikshme dhe të hollësishme, siç është pyetja e prokurorit të dyshuar për korrupsion pasiv, A. K., ballafaqimi i këtij të fundit me personin nën hetim A. L., analiza e tabulateve telefonike të personit nën hetim dhe familjarëve të personit nën hetim, verifikimi i thënieve të personit në hetim A. L., të para këto në harmoni me vendimin e pushimit të procedimit penal nga prokurori A. K. për shtetasin A. L., etj.
62. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.
63. Për sa më sipër, është i drejtë vendimi i Komisionit kur konkludon se, nga ana e subjektit të rivlerësimit është kryer një hetim i paplotë, si dhe nuk ishin mbledhur të gjitha provat e kërkuara, për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv në përputhje me nenin 73, pika 2, e ligjit nr. 96/2016.

Lidhur me shkaqet e tjera të ngritura në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si vijon:

64. *Lidhur me kërkesën e ankuesit për verifikim nga Kolegji të kushteve të emërimit të komisionerit Lulzim Hamitaj, me qëllim konstatimin e pavlefshmërisë së emërimit të tij në detyrë*, trupi gjykues vlerëson se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka kompetencë për të konstatuar pavlefshmërinë e emërimit në detyrë të një anëtari të institucioneve të rivlerësimit, por vetëm për të hetuar dhe

gjykuar shkeljet disiplinore të tyre, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, dhe për të cilat mund të vihet në lëvizje vetëm sipas parashikimeve të nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.

65. *Lidhur me pretendimin e ankuesit se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas parashikimeve të këtij neni, subjekti i rivlerësimit mund të shkarkohet nëse plotësohen në mënyrë kumulative dy kritere, pamjaftueshmëri në kontrollin e figurës dhe në atë të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra.*

Neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: "...Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave", ndërkohë që neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: "Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.". Duke interpretuar dispozitat e mësipërme në mënyrë sistematike, Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret, dhe bazuar në nenin D, pika 5 të aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarin të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive. Gjithashtu, edhe neni DH i Aneksit të Kushtetutës bën një rregullim të kriterit të figurës, të posaçëm dhe të pavarur nga kriteri i pasurisë, dhe në të cilin parashikohet shkarkimi nga detyra qoftë edhe vetëm për pamjaftueshmëri të figurës. Për sa më sipër nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.

66. *Lidhur me pretendimin se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016 dhe ligjin nr. 96/2016, pasi Komisioni i ka atribuuar vetes kompetenca që i përkasin organeve të tjera, të cilat kontrollojnë figurën dhe etikën e magjistratit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka të drejtë të bëjë vlerësimin e tij në lidhje me provat e gjendura në dosje sipas nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se "Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.*

67. *Lidhur me pretendimin se vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenet 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi objekt kontrolli i Komisionit janë deklarinimet e bëra deklarinatën përkatëse në aneks të ligjit, dhe jo saktësia e deklarinatave të bëra në vite në ILDKPKI, vlerësojmë si vijon: Neni D, pika 1, e Aneksit të Kushtetutës, parashikon se "Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarinimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklarinuar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur", ndërkohë, neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se "Deklarinimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimt". Në interpretim të dispozitave të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe ligjit është e tillë që nga ky proces i rivlerësimit të verifikohen dhe të gjithë ata që nuk i kanë deklarinuar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre. Për sa më sipër nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*

68. *Lidhur me pretendimin se në seancën dëgjimore të datës 14.06.2018, nga ana e Komisionit është lejuar një shkelje e rëndë procedurale në kundërshtim me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 pasi vëzhguesi ndërkombëtar ka ndërhyrë në kundërshtim me ligjin, duke mos bërë pyetje, por duke dhënë komente dhe opinione, të cilat cenonin dinjitetin e subjektit, trupi gjykues çmon se*

Kushtetuta nuk ka parashikuar ndalime në lidhje me momentin e paraqitjes së gjetjeve dhe mendimeve nga ana e vëzhguesve ndërkombëtarë, gjë që mund të bëhet gjatë seancës dëgjimore pranë Komisionit, gjatë seancës gjyqësore pranë Kolegjit, me rekomandimet përkatëse drejtuar Komisionerit Publikë për të ushtruar të drejtën e ankimit, si dhe gjatë pjesëmarrjes së tyre në dhomën e këshillimit pranë Komisionit dhe/ose Kolegjit. Në çdo rast vëzhguesit ndërkombëtarë janë të pranishëm, por asnjëherë ata nuk ndikojnë në vendimmarrje. Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.

69. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim të hapur me nenin 17 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të KEDNJ, vlerësojmë se ky pretendim i ankuesit është i përgjithshëm dhe nuk ka specifikuar konkretisht se cilat janë shkeljet e bëra nga Komisioni në kuadër të dispozitave të sipërcituara. Referuar e-mail-it të datës 28.05.2018, Komisioni e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për të ushtruar të gjitha të drejtat e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që nga subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur më parë asnjë kërkesë, për shembull përmes të cilës të kërkohej më shumë kohë për përgatitjen e përgjigjeve, apo vërejtje të tij apo avokatit të tij mbrojtës, lidhur me momente procedurale në fazën e hetimit administrativ.*
70. *Lidhur me pretendimin se Komisioni ka shkelur parimin për një proces të rregullt ligjor, duke paragjykuar çështjen dhe duke paracaktuar vendimin, pasi i njëjti komision që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, i njëjti Komision (me të njëjtët anëtarë) ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit, vlerësojmë se Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar një trup gjyqësor të ndryshme për të bërë hetimin dhe një tjetër për të dhënë vendimin. Sipas Nenit C, pika 1 e aneksit të Kushtetutës, Komisioni përbëhet nga katër trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili. Ndërkohë që, neni 14 i ligjit nr. 84/2016 ka parashikuar në mënyrë të qartë procedurën e përzgjedhjes së trupit gjykues të Komisionit, si dhe detyrat e kryesuesit dhe relatorit.*
71. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe se nuk ka respektuar parimin e kontradiktoritetit dhe atë të gjykimit në seancë publike, çmojmë se nga ana e Komisionit janë pranuar në cilësinë e provës të gjitha shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që është kompetencë e Komisionit t'i caktojë secilës prej tyre vlerën provuese, në përputhje dhe harmoni me të gjitha provat e tjera të mbledhura sipas ligjit. Lidhur me zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, nga vlerësimi i akteve të gjendura në dosjen e gjykimit, referuar e-mail-eve të Komisionit të datës 24.02.2018, 26.02.2018, dhe 05.03.2018, si dhe përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit të datës 05.03.2018, 07.03.2018, dhe 03.04.2018 (fashikulli 11/3) ku i kërkohet subjektit të parashtrojë prova dhe argumente për secilën nga gjetjet e Komisionit, si dhe referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, ku i jepet mundësia subjektit të rivlerësimit të prapësojë lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar dhe të japë shpjegime lidhur me secilën nga pyetjet e shtruar nga anëtarët e trupit gjykues, vlerësojmë se parimi i kontradiktoritetit është zbatuar më së miri. Ndërkohë që lidhur me zbatimin e parimit gjykimit në seancë publike, nga vlerësimi i akteve të gjendura në dosjen e gjykimit (shih procesverbalin e seancës dëgjimore, pranë Komisionit ka qenë publike dhe me praninë e medias.) Për gjithë sa më sipër nuk qëndrojnë këto pretendime të ankuesit.*
72. *Lidhur me pretendimin se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me vendime të tjera të Komisionit të dhëna më pas për subjekte që kanë kaluar me sukses kualifikimin, pasi duke bërë krahasimin me këto vendime, del qartë edhe qëndrimi diskriminues në krahasim me të tjerë subjekte, duke bërë edhe shkelje të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe*

*protokollit respektiv, si dhe me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të marrë si prova të reja edhe vendimet e Komisionit për subjektet e kualifikuar, vlerësojmë se nuk qëndron ky pretendim i ankuesit, pasi nga komisioni nuk është bërë asnjë shkelje diskriminuese bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër. Ndërkohë që lidhur me kërkesën për të marrë si provë të re vendimet e Komisionit për subjektet e kualifikuar, ajo gjendet e pabazuar, sepse Kolegji nuk mund të marrë në shqyrtim vendimet e Komisionit për këto subjekte, duke qenë se parashikohet qartë në nenin 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 mënyra se si vihet në lëvizje Kolegji dhe subjektet që legjitimohen ta bëjnë këtë. Në rastin në fjalë, subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova nuk legjitimohet të ngrejë një kërkesë të tillë, për më tepër që *case law* nuk gjen zbatim në të drejtën shqiptare. Kjo kërkesë e subjektit të rivlerësimit mund të vlerësohet nga Kolegji në momentin e shqyrtimit të ankimeve të mundshme për vendimet e përmendura nga subjekti i rivlerësimit në dritën e dhënies së vendimeve orientuese në kuadër të nenit 66, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*

73. *Lidhur me pretendimin se Komisioni nuk është gjykatë në kuptimin e nenit 6 KEDNJ, por më së shumti një organ administrativ, e për këtë arsye, Kolegji duhet ta shqyrtojë çështjen si gjykatë e shkallës së parë, vlerësojmë se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar, pasi në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shprehimisht shkruhet: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese.” Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet sipas nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, i cili referon në zbatimin e neneve 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012. Në qoftë se Kolegji e vlerëson se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore publike atëherë mund të ndjek rregullat e shqyrtimit si shkallë e parë.*
74. *Lidhur me pretendimin se pika 3 dhe 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 bien në kundërshtim me Kushtetutën, e se për këtë Kolegji duhet të pezullojë gjykimin për t’ia dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese për interpretim, vlerësojmë si vijon: Neni F, pika 3, fjalia e tretë, e aneksit të Kushtetutës parashikon se “Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.” Referuar sa më sipër si edhe vendimit nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese, i cili në pikën 68 të tij parashikon ndër të tjera se: “Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën”, ky pretendim i ankuesit nuk mund t’i nënshtrohet gjykimin incidental për kushtetutshmëri të pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe çdo pretendim për shkelje të parimeve kushtetuese do të vlerësohet rast pas rasti nga Kolegji. Sa i takon pajtueshmërisë së dispozitave të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, Neni F, pika 3, fjalia e tretë, e aneksit të Kushtetutës, si dhe vendimi nr. 2, datë 18.01.2017 i Gjykatës Kushtetuese, që ka gjykuar pajtueshmërinë e ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, i jep zgjidhje kërkesës në fjalë, e për këtë arsye ky pretendim i ankuesit nuk qëndron.*
75. *Lidhur me pretendimin se vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenin 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, vlerësojmë se, Komisioni prezumohet t’i ketë kontrolluar të gjitha dokumentet që i përkasin veprimtarisë profesionale të subjektit rivlerësimit, dhe më pas ka proceduar me vlerësimin e vetëm atyre dokumenteve ligjorë, mbi të cilët ka konstatuar problematika, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës sipas ligjit vetëm për ato dokumente. Neni 45 i ligjit nr. 84/2016 parashikon ndër të tjera se: “Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme*

për procedurën e rivlerësimit.

Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit .”

Pra, bazuar në këtë dispozitë Komisioni dhe Kolegji mund të administrojnë dhe shqyrtojnë aq dokumente ose qoftë edhe situata subjektive sa gjykohet e nevojshme për të përmbyllur procedurën e rivlerësimit të subjektit. Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.

76. *Lidhur me pretendimin se Komisioni ka gabuar kur nuk ka marrë në konsideratë raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, vlerësojmë se, në nenin “E” të Aneksit të Kushtetutes si dhe nenet 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 është përcaktuar qartë mënyra e rivlerësimit përsa i përket kriterit të aftësisë profesionale të subjektit dhe vlera provuese e raportit.*
77. *Lidhur me pretendimin e ankuesit se Komisioni ka shkelur nenet 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, nenet 3, 36, dhe 37 të ligjit nr. 49/2012, pasi subjekti i rivlerësimit nuk është njoftuar paraprakisht për konkluzionin e arritur më parë nga Komisioni, si dhe se nuk i janë bërë të ditura rrethanat e konstatuara nga Auditimi i Pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit, vlerësojmë se subjektit të rivlerësimit i janë bërë me dije të gjitha rezultatet e hetimit, si dhe e drejta e tij për t’u njohur me të gjithë përmbajtjen e dosjes në ngarkim të tij, në të cilën gjendej në cilësinë e provës edhe raporti i Auditit të Pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit.*
78. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar kur nuk i ka komunikuar në rezultatet e hetimit administrativ faktin e përmendur në vendim në lidhje me “ndërtim të paligjshëm”, duke bërë që procesi të bëhet i pavlefshëm dhe i parregullt ligjor, vlerësojmë se nuk qëndron ky pretendim i ankuesit, pasi në rezultatet paraprake të hetimit administrative, në pikën II - Ndërtimi i shtesës së një kati mbi apartamentin në rr. “{***}”, p. {***}, sh. {***}, ap {***}, (kt. {***}), pika 3, përshkruhet ndër të tjera si vijon: “Sipër këtij apartamenti është realizuar një ndërtim shtesë, me sipërfaqe 62,90 m², ndërtim pa leje, ...” Përsa më sipër nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*
79. *Lidhur me pretendimin e ankuesit se Komisioni ka gabuar kur ka përllogaritur si shpenzim udhëtimin në Milano në vitin 2007, shprehemi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se ka qenë në Milano për arsye pune, dhe as faktin se përse nuk ka arritur të sigurojë dokumentin që do ta vërtetonte pamundësinë për të vënë në dispozicion të Komisionit këtë dokument (neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016). Për këto arsye, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*
80. *Lidhur me pretendimin e ankuesit se në total pasuria në pronësi dhe përdorim është 9.000.000 lekë, ndërsa të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes janë rreth 21.000.000 lekë, nga analiza ekonomike e kryer në Kolegj, rezultoi se të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të janë në total 20.278.038 lekë, shpenzimet janë në total 17.413.673 lekë, ndërsa pasuria neto 8.159.827 lekë, duke pasur kështu një diferencë negative prej -4.495.462 lekësh. Sipas kësaj analize financiare të bërë nga Kolegji rezultoi se subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në shumën prej -4.495.462 lekësh, sipas nenit 33, pika 5/b e ligjit nr. 84/2016.*
81. *Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit çmon se vendimi i Komisionit nr. 25, datë 20.06.2018, është marrë në bazë të një shqyrtimi të plotë dhe të gjithanshëm të akteve, në bazë të një analize të plotë të fakteve juridike dhe financiare, si dhe provueshmërisë së plotë të tyre në përputhje me përcaktimet e neneve 33, 45, 52 të ligjit nr. 84/2016.*

82. Trupi gjykues pasi analizoi çështjen në tërësi, shkaqet e ankimit, lidhur këto me provat e administruara në këtë çështje arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova:

- i. Ka fshehur dhe ka bërë deklaram të rremë për pasuritë.
- ii. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
- iii. Rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.
- iv. Ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Gentian Trenova është në kushtet e nenit D, pikat 3 dhe 5 dhe nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 25, datë 20.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Trenova.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall sot, në Tiranë, më datë 19.11.2018.

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi

ANËTAR

Luan Daci

nënshkrimi

RELATORE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina Rama

nënshkrimi